



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZË E TREGUT TË SHËRBIMEVE POSTARE

DHE

VLERËSIMI I OFRUESVE TË MUNDSHËM TË SHËRBIMIT

UNIVERSAL

Dokument Përfundimtar
(Miratuar me VKD nr.10, datë 27.08.2025)

Përmbajtja:

I. HYRJE

- I.1 Struktura e dokumentit.....
- I.2 Kuadri ligjor dhe rregullator.....
- I.3 Detyrimi për Shërbimin Universal Postar.....
- I.4 Ofruesit e shërbimeve postare.....

II. Analiza e tregut të Shërbimeve Postare.....

- II.1 Ndarja e tregut të shërbimit jouniversal postar.....
- II.2 Ndarja e tregut të shërbimit postar ekspres.....
- II.3 Treguesit financiarë.....
- II.4 Struktura e të ardhurave të tregut postar.....
- II.5 Investimet në sektorin postar.....

III Treguesit Teknik dhe të Rrjetit.....

- III.1 Cilësia dhe standardet e realizimit të shërbimeve postare.....
- III.2 Të punësuarit.....
- III.3 Ankesat e pranuar dhe të zgjidhura.....

IV. Ofrimi i shërbimi universal postar nga Posta Shqiptare.....

- IV.1 Autorizimi individual për shërbimin universal.....
- IV.2 Plotësimi i detyrimeve nga posta shqiptare për shërbimin universal.....
- IV.3. Monitorimi kriterëve të shërbimit universal.....

V. Vlerësimi i ofruesve të mundshëm të Shërbimit Universal postar.....

- V.1 Baza rregullatore për analizën e tregut dhe vlerësimin e numrit të ofruesve të mundshëm të shërbimit postar
- V.2 Kriteret për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar.....

Aneks 1- Lista e sipërmarrësve të ofrimit të shërbimeve postare.....

Terma dhe Shkurtime

AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
PSH	Posta Shqiptare
Shërbim universal postar	Një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme, sipas përcaktimeve në nenin 12 të ligji 46/2015.
Autorizim individual	Autorizimi i lëshuar nga AKEP, me anë të të cilit një ofruesi të shërbimit postar i jepen të drejta të veçanta dhe i vendosen detyrime specifike plotësuese ndaj autorizimit të përgjithshëm.
Ofruesi i shërbimit universal	Sipërmarrësi që ofron shërbimet universale, sipas këtij ligji.
UPU	Bashkimi i Përbotshëm Postar
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

I. HYRJE

Ligji Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” përcakton rregullat për ofrimin e shërbimit postar dhe shërbimit universal postar, si dhe organet përgjegjëse për rregullimin e sektorit. Një fokus i veçantë në ligjin nr. 46/2015 i kushtohet sigurimit të shërbimit universal postar në gjithë territorin e RSH sipas kërkesave specifike të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.

Sektori postar përbën një sektor të rëndësishëm të ekonomisë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të komunikimit postar për qytetarët dhe bizneset, dhe veçanërisht në ofrimin e shërbimit bazë apo universal postar, për të garantuar komunikimin postar dhe në zona të largëta, si dhe përdorimin e shërbimeve dhe në situata të emergjencës siç ishte dhe gjatë periudhës së mbylljes për shkak të pandemisë Covid-19.

Tregu i ofrimit të shërbimeve postare në Shqipëri ka kaluar një proces ndryshimesh të shtrira në kohë duke ndjekur modelin e vendeve të BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Transformimi ka kaluar nga ofrimi i shërbimeve postare tradicionale në kushte monopolistike, drejt një tregu të hapur në mënyrë graduale për konkurrencë ku ofrimi i këtyre shërbimeve ndihmohet dhe nga zhvillimet teknologjike dhe modernizimi i infrastrukturës.

Tregjet postare vitet e fundit po marrin një zhvillim të shpejtë, në ndërlidhje të përbashkët me zgjerimin e tregjeve të komunikimeve elektronike, marketingut/reklamave dhe tregtisë elektronike. Zhvillimet në tregun postar tregojnë për një tendencë globale në reduktimin e volumit të postës së letrave dhe rritjen e shpejtë të dërgesave të pakove, si rezultat i zhvillimit të vullshëm të tregtisë elektronike. Në sektorin postar, digjitalizimi dhe e-Zëvendësueshmëria është një nga çështjet që diskutohet prej vitesh për impaktin që ka në tregun e postës së letrave, por njëkohësisht dhe për mundësitë që digjitalizimi ofron në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve postare.

Komunikimet elektronike janë të shtrira gjerësisht sot dhe numri i shërbimeve publike që ofrohen në rrugë elektronike është rritur ndjeshëm. Një pjesë e mirë e komunikimeve me institucionet publike janë zëvendësuar me aplikime online, duke sjellë përfitime dhe lehtësira të padiskutueshme për publikun. E parë thjesht në këndvështrimin e sektorit postar, kjo mënyrë e re e marrjes së shërbimeve çon në reduktimin e postës së letrave. Nga ana tjetër, është një mundësi përmes digjitalizimit. Aksesit për shërbimet elektronike është një mundësi e shtuar për marrjen e shërbimeve cilësore në zyrat e ofruesit të shërbimit universal, pasi në zyrat postare ofrohen shumë shërbime në të njëjtën pikë.

Objektivi primar rregullator duhet të vazhdojë të jetë promovimi i konkurrencës efektive në tregun e shërbimeve postare, formalizimi i tregut vendas, si edhe mbrojtja e nevojave të përdoruesve dhe ofrimi i shërbimit cilësor. Për më tepër, është i nevojshëm edhe synimi i objektivave specifike, siç mund të jetë promovimi i rrjetit postar të fortë dhe të qëndrueshëm, si edhe prezantimi i shërbimeve novatore, të afta për të garantuar marrjen e shërbimeve postare cilësore dhe me çmime të përballueshme.

AKEP, si organ rregullator në fushën e shërbimeve postare, ndër të tjera, ka detyrimin për të përcaktuar ofruesin e shërbimit universal postar në përputhje me ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore edhe rregullat për ofrimin e shërbimit postar dhe shërbimit universal postar. Mbi këto përcaktime, bazuar në procesin e

analizës së tregut postar të zhvilluar nga AKEP, në vitin 2020 ofruesi i shërbimit postar Posta Shqiptare sh.a., është përcaktuar si ofrues i shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Këshillit Drejtues i AKEP-it me vendim nr.13, datë 30.6.2020, ka pajisur ofruesin Posta Shqiptare sh.a., me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjeçar, nga hyrja në fuqi e vendimit. Afati i përfundimit i vlefshmërisë së autorizimit individual të Posta Shqiptare për shërbimin universal postar ka përfunduar më 7 korrik 2025.

Në vijim të përcaktimeve të mësipërme, AKEP ka hartuar dokumentin “Analizë e Tregut të shërbimeve postare”, dokument i cili përmban analizën e tregut postar dhe vlerësimin e numrit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal postar sipas parashikimeve të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 239, datë 2.5.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal”.

Dokumenti përmban një analizë të ecursisë së treguesve të tregut postar në Shqipëri, duke u fokusuar në shërbimin universal, si dhe në vlerësimin e kapaciteteve tekniko-ekonomike të ofruesve aktualë të shërbimit postar për të ofruar shërbimin universal postar në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 46/2015 dhe akteve nënligjore të tij.

Dokumenti i përgatitur pas miratimit nga Këshilli Drejtues i AKEP me Vendim nr.6, datë 19.05.2025 – Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”, iu njoftua palëve të interesuara, sipërmarrësve të shërbimeve postare, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës, si dhe u publikua në faqen e internetit të AKEP për këshillim publik për një periudhë 30 ditore nga data 19 maj-18 qershor 2025. Në përfundim të procesit të këshillimit publik nuk u paraqitën komente nga palë të interesuara.

Nga dokumenti përfundimtar i analizës së tregut të shërbimeve postare potencialisht rezulton se Posta Shqiptare sh.a. plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin, sipas parashikimeve të VKM nr. 239, datë 2.5.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar”.

Nga analiza përfundimtare rezulton se në treg ka vetëm një operator që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi, Posta Shqiptare sh.a.

Për këto arsye, AKEP-i do të miratojë zgjatjen e afatit të autorizimit individual të operatorit ekzistues Posta Shqiptare sh.a., për sigurimin e shërbimit universal postar dhe do të miratojë autorizimin e ri individual, sipas parashikimeve në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

I.1 Struktura e dokumentit

Në Kreun I të dokumentit përshkruhet në mënyrë të përgjithshme rëndësia e shërbimeve postare në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe lidhjet me tregjet e tjera, në kushtet kur marrëdhëniet tregtare dhe shërbimet e tjera financiare po kërkojnë gjithnjë e më shumë mbështetje në tregun e shërbimeve postare.

Në Kreun II paraqitet baza ligjore dhe rregullatore mbi të cilën AKEP realizon analizën e

tregjeve të shërbimeve postare dhe miratimin e autorizimit për shërbimin postar universal.

Në Kreun III referohet analiza e tregut përkatës të shërbimeve postare nga ku rezulton se Posta Shqiptare, si ofrues i shërbimit universal gjatë viteve të fundit, mbizotëron tregjet përkatëse.

Në Kreun IV është analizuar plotësimi i kriterëve ligjore dhe rregullatore nga ana e Postës Shqiptare, sipas raportimeve të përvitshme pranë AKEP, dhe rezultatet e inspektimeve që ka realizuar AKEP pranë Postës Shqiptare sh.a., sa i përket shërbimit universal.

Në Kreun V është analizuar numri i ofruesve potencialë të shërbimit universal postar sipas kriterëve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore.

I.2 Kuadri ligjor dhe rregullator

Ofrimi i shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë rregullohet mbi bazën e përcaktimeve të ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si edhe akteve të tjera nënligjore (VKM, udhëzime, urdhra dhe rregulloreve të AKEP). Kuadri ligjor për shërbimet postare është plotësisht i përafuar me direktivën 97/67/KE, të ndryshuar nga direktiva 2002/39/KE dhe direktiva 2008/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 20 shkurt 2008 dhe përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve postare në një treg të hapur, synon garantimin e ofrimit të shërbimit universal postar nga më shumë se një ofrues, si dhe skemën e financimit të kostove neto të shërbimit universal postar.

AKEP-i është autoriteti rregullator kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, i cili është krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike, ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Kompetencat e AKEP-it në sektorin postar janë përcaktuar në nenin nr. 9 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”. Referuar këtij ligji, AKEP përcakton ofruesin e shërbimit universal postar dhe mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve të shërbimit universal postar. Çdo përdorues në Republikën e Shqipërisë gëzon të drejtën e shërbimit universal postar, që përfshin ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit postar me një cilësi të përcaktuar në rregulloren e miratuar nga AKEP-i dhe me çmime të përballueshme në të gjitha pikat e aksesit brenda territorit të tyre. AKEP mbron të drejtat e përdoruesve të shërbimeve postare, duke promovuar konkurrencën në tregun e ofrimit të shërbimeve postare.

Në kuadrin institucional në fushën e sektorit postar, detyrat e politikëbërësit dhe rregullatorit janë të ndara midis ministrisë përgjegjëse dhe rregullatorit. Sipas përcaktimeve të nenit 5 të ligjit nr. 46/2015, organet kompetente në fushën e shërbimeve postare janë ministria përgjegjëse për shërbimet postare, aktualisht Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë, si politikëbërëse, dhe AKEP-i, si organi rregullator i pavarur.

Ligji nr. 46/2015 përmban kuadrin rregullator për ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve postare dhe shërbimin universal postar, si dhe kushtet për akses në rrjetin postar në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i këtij ligji është siguri i ofrimit të shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji përcakton parimet për vendosjen e tarifave, kërkesat për transparencën e llogarive në ofrimin e shërbimeve universale, standardet për cilësinë në ofrimin e shërbimeve universale, si dhe garanton funksionimin e autoritetit të pavarur kombëtar rregullator.

Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 46/2015, janë miratuar vendime që lidhen me ofrimin e shërbimeve postare dhe ofrimin e shërbimit universal postar, konkretisht:

- VKM nr. 360, datë 11.5.2016, “Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit, në rastin e bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimit universal postar”;
- VKM nr. 239, datë 2.5.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimeve universale postare”;
- VKM nr. 207, datë 6.4.2022, “Për miratimin e dokumentit të politikës së shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, 2021 e në vijim”.

Gjithashtu, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 46/2015, janë miratuar një sërë aktesh të tjera nënligjore nga MIE dhe AKEP, të cilat plotësojnë setin e akteve rregullatore në fushën e ofrimit të shërbimeve postare në Shqipëri, të cilat do të trajtohen në pjesën e dokumentit në vijim.

I.3 Detyrimi për Shërbimin Universal Postar

Pika 1 e nenit 12 të ligjit nr. 46/2015, përcakton se, çdo përdorues në Republikën e Shqipërisë gëzon të drejtën e shërbimit universal postar, që përfshin ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit postar me një cilësi të përcaktuar në rregulloren e miratuar nga AKEP dhe me çmime të përballueshme në të gjitha pikat e aksesit brenda territorit të tyre.

Gjithashtu, neni 12 në pikën 2, përcakton që shërbimi universal postar përfshin kërkesat minimale të mëposhtme:

- a) pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e objekteve postare që peshojnë deri në 2 kg;
- b) pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e pakove postare që peshojnë deri në 10 kg;
- c) shërbimet për objektet postare të regjistruara dhe objektet postare të siguruara.

Ofruesi i shërbimit universal duhet të sigurojë shërbimin universal për çdo përdorues të paktën 5 ditë në javë, duke ofruar minimalisht, me përjashtim të rrethanave ose kushteve gjeografike, të cilat konsiderohen të jashtëzakonshme:

- a) pranimin e objektit postar;
- b) shpërndarjen e objektit postar në banesë ose në ambientet e çdo personi fizik apo juridik.

“Shërbim universal postar” është një minimum i përcaktuar shërbimesh të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme për përdoruesit.

Pavarësisht nga kufiri i peshës për pakot postare, i përcaktuar sipas këtij ligji, ofruesi/t e shërbimit universal postar duhet të sigurojnë që objektet postare, të pranuar në një vend anëtar të BE-së dhe që peshojnë deri në 20 kg, të shpërndahen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shërbimi universal postar mbulon shërbimet postare brenda vendit, si dhe ato ndërkufitare.

AKEP, në mbështetje të nenit 64 pika, 3 të ligjit nr. 46/2015, me VKD të AKEP nr.13, datë 30.6.2020, ka pajisur ofruesin “Posta Shqiptare sh.a.” me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar me afat 5 vjeçar.

Posta Shqiptare sh.a., ka detyrimin që të ofrojë shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të Autorizimit Individual si dhe sipas përcaktimeve të ligjit nr. 46/2015, datë 7.5.2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore dhe rregullatore të sektorit postar.

Në plotësim të kërkesave të nenit 65, të ligjit nr. 46/2015, për nxjerrjen e akteve nënligjore të sektorit postar, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjetikës ka nxjerrë:

- Udhëzimin nr. 4038, datë 4.9.2015, “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”, i cili përcakton detyrimet e ofruesit të shërbimit universal, për ofrimin e objekteve postare cekograme pa pagesë për personat e verbër ose pjesërisht të verbër;
- Urdhrin nr. 469, datë 27.12.2019, "Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar", duke marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve për prezencë sa më të gjerë të pikave të aksesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Urdhrin nr.5, datë 25.6.2021, “Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare”;
- Urdhrin nr. 425, datë 12.11.2021, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e tarifave të dërgesave të pakove ndërkufitare”.

AKEP, në zbatim të nenit 64 të ligjit nr. 46/2015, ka miratuar paketën e plotë rregullatore të ofrimit të shërbimeve postare, pjesë e së cilës është dhe Rregullorja nr. 36, datë 29.10.2015, “Për ofrimin e shërbimit universal postar”, miratuar me VKD nr. 2627, datë 29.10.2015, në të cilën janë përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga rrjeti postar i një ofruesi të shërbimit universal, me qëllim përmbushjen e standardeve të cilësisë së shërbimit postar.

Sipas kërkesave të Autorizimit Individual, Posta Shqiptare sh.a., duhet të zbatojë:

1. *Detyrimin e ofrimit të shërbimit universal postar çdo përdoruesi në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, duke përfshirë shërbimet postare brenda vendit dhe ndërkombëtare;*
2. *Organizimin e rrjetit postar me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar sipas kërkesave të ligjit 46/2015 dhe akteve rregullatore të miratuara nga AKEP për ofrimin e shërbimit universal postar;*
3. *Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar;*
4. *Parimet për përcaktimin e tarifave dhe kostove për ofrimin e shërbimit universal postar.*

Për sigurimin e ofrimit të shërbimit universal postar, AKEP-i mund të caktojë:

- a) *një ose më shumë ofrues të shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit universal postar në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

- b) ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar, për sigurimin e elementeve të veçanta të një shërbimi universal postar, nëse është e përshtatshme me kushtet specifike të tregut postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezulton që këto shërbime nuk ofrohen;
- c) ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar për mbulimin e zonave të ndryshme të territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse është e përshtatshme me kushtet specifike të tregut postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezulton që këto shërbime nuk ofrohen në zonën përkatëse. Zona minimale e territorit për përcaktimin e një ofruesi të shërbimit universal postar, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përcaktimi i ofruesit/esve të shërbimit universal postar, bëhet me vendim të AKEP-it, bazuar në parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit universal postar, duke konsideruar rolin e rëndësishëm që shërbimi universal postar luan për shoqërinë, si dhe duke siguruar trajtimin e barabartë të përdoruesve në gjithë territorin.

Në përcaktimin e ofruesit/esve të shërbimit universal postar, AKEP, në veçanti, merr në konsideratë:

- a) rrethanat dhe zhvillimin e tregut të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë dhe nevojën e zbatimit të shërbimit universal postar;
- b) aftësitë teknike, përfshirë sistemin e informacionit, për ndjekjen e objekteve postare, financiare dhe besueshmërinë e ofruesit për sigurimin e shërbimit universal postar në një zonë të caktuar ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe kohore të përcaktuar;
- c) pikat e aksesit të rrjetit postar të ofruesit të shërbimit universal postar;
- d) kostot përkatëse neto për ofrimin e shërbimit universal postar, si dhe, për sa është e zbatueshme, vlerën korresponduese të kompensimit, që mund të kërkohej nga operatori për ofrimin e shërbimit universal postar.

Qëndrueshmëria e Shërbimit Postar dhe Ndarja e Llogarive

Sa i përket qëndrueshmërisë së shërbimit postar, operatori publik postar siguron qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimit universal postar, nga të ardhurat e krijuara nga ofrimi i shërbimit universal postar.

Në lidhje me ndarjen e llogarive, në nenin 31 të ligjit nr. 46/2015, përcaktohet se:

- Ofruesit e shërbimeve postare, që ushtrojnë një ose disa aktivitete të tjera biznesi, të ndryshme nga shërbimi postar i ofruar, duhet të zbatojnë ndarje të llogarive, për të evidentuar të ardhurat që vijnë nga shërbimet postare si zë më

vete dhe të ndara nga të ardhurat që vijnë nga aktivitete të tjera të biznesit;

- Ofruesit e shërbimit universal postar duhet të mbajnë llogari të ndara, brenda sistemit të tyre të kontabilitetit, për të dalluar, në mënyrë të qartë, shërbimet dhe produktet që janë pjesë e shërbimit universal postar dhe ato që nuk janë pjesë e këtij shërbimi, me qëllim llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar.

I.4 Ofruesit e shërbimeve postare

Sipas legjislacionit në fuqi, shërbimet postare në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të ofrohen nga çdo person fizik ose juridik, kundrejt autorizimit nga AKEP. Kriteret dhe kushtet e detajuara për autorizimin për ofrimin e shërbimeve postare, janë të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 46/2015, si dhe në rregulloret përkatëse, konkretisht:

- Rregullore nr. 38, datë 19.11.2015, “Për autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”; dhe
- Rregullore nr. 36, datë 29.10.2015, “Për ofrimin e shërbimit universal postar”.

Neni 7 i rregullores nr. 38, datë 19.11.2015, “Për autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, përcakton ofrimin e shërbimeve të tjera postare që ofrohen jashtë kushteve të shërbimit universal, që përfshijnë:


- a) Shërbimin e pranimi, përpunimit, transportit dhe shpërndarjes të objekteve postare të postës së shpejtë - Postë Expres, brenda vendit/me jashtë;
- b) Shërbimin e pranimi, përpunimit, transportit dhe shpërndarjes të objekteve postare - Jo Expres, brenda vendit/me jashtë;
- c) Shërbimin e shpërndarjes së objekteve të paadresuara për publicitet;
- d) Shërbimin e shkëmbimit të dokumenteve;
- e) Shërbimin e dorëzimit të objekteve postare me shumicë;
- f) Shërbimi i postës direkte;
- g) Shërbimi i postës hibride.

II. Analiza e tregut të Shërbimeve Postare

AKEP kryen analizën e tregut postar dhe vlerësimin e numrit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal postar sipas parashikimeve të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 239, datë 2.5.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal”, bazuar në të dhënat statistikore dhe financiare periodike të dërguara nga ofruesit, si dhe mbi informacionet e administruara nga procedurat e inspektimeve.

Në analizën e kërkesave teknike minimale për shërbimin universal postar, AKEP bën vlerësimin e tyre bazuar në nenet 12, 13, e 14 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Grafik 1. Ecuria e volumit të objekteve të shërbimit universal postar 2020 – 2024



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP, nga ofruesit e shërbimeve postare

Siç vihet re, nga të dhënat e grafikut të mësipërm, në shërbimin universal postar, pjesën më të madhe të tregut e zotëron posta brenda vendit, e cila luhetet mbi nivelin 95% përgjatë gjithë periudhës 2020 – 2024.

Po kështu, nga të dhënat e paraqitura në këtë grafik, evidentohet fakti se volumi i objekteve postare të shërbimit universal ka shënuar rritje përgjatë periudhës 2020 – 2022, duke arritur nivelin e rreth 22 milionë objekte postare, ndërkohë që vërehet se gjatë vitit 2023 ka pasur një rënie të ndjeshme të këtij numri, e cila është pasuar nga rritje e lehtë përgjatë vitit 2024.

II.1 Ndarja e tregut të shërbimit jo-universal postar

Në tabelat në vijim paraqitet informacion përmblledhës për shërbimin jouniversal postar të përpunuara nga të gjithë operatorët postarë që ofrojnë këtë shërbim, ku përfshihet edhe Posta Shqiptare.

Tabela 1. Shërbimi jouniversal postar *Posta Shqiptare* vs. *Operatorët e tjerë*

Viti	Posta Shqiptare		Operatorët e tjerë		Totali
	Postë brenda vendit	Postë ndërkombëtare	Postë brenda vendit	Postë ndërkombëtare	
2020	873,512	2,344	1,914,761	45,036	2,835,653
2021	301,052	2,762	1,757,313	77,419	2,138,546
2022	406,700	3,149	956,465	45,072	1,411,386
2023	402,014	3,320	457,644	21,847	884,825
2024	366,523	623	746,641	6,441	1,120,228

Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP, nga ofruesit e shërbimeve postare

Tabela 2. Shërbimi jouniversal postar, mbulimi i tregut postar brenda vendit vs. ndërkombëtar

	Postë brenda vendit		Postë ndërkombëtare	
	Posta Shqiptare	Operatorët e tjerë	Posta Shqiptare	Operatorët e tjerë
2020	31%	69%	5%	95%
2021	15%	85%	3%	97%
2022	30%	70%	7%	93%
2023	47%	53%	13%	87%
2024	33%	67%	9%	91%


Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP, nga ofruesit e shërbimeve postare

Të dhënat e paraqitura më sipër tregojnë qartë se, ofruesit e tjerë të shërbimeve jouniversal postar, zotërojnë pjesën më të madhe të tregut për sa i përket numrit të objekteve postare që nuk janë pjesë e shërbimit universal. Ky tregues është më i lartë për ofruesit e tjerë postarë në krahasim me Postën Shqiptare, si për sa i përket volumit të objekteve postare brenda vendit, ashtu edhe për objektet që i përkasin postës ndërkombëtare.

Pjesët e tregut për shpërndarjen e objekteve postare të shërbimit jouniversal nga ofruesit e tjerë postarë përgjatë periudhës 2020 – 2024, variojnë në nivelet 53% deri në 85% për postën brenda vendit, ndërkohë pjesët e tregut të këtyre ofruesve për postën ndërkombëtare janë më të larta, ku ky tregues luhet në kufijtë 87%– 97% përkundrejt Postës Shqiptare.

Sipas të dhënave të mësipërme, gjatë vitit 2024, në ndryshim nga të dhënat e raportuara për vitin 2023, operatorët e tjerë kanë rritur pjesën e tregut si për postën brenda vendit ashtu edhe për postën ndërkombëtare.

Grafik 2. Shërbimi jouniversal postar në total, mbulimi i tregut Posta shqiptare vs. Op. tjerë




Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP, nga ofruesit e shërbimeve postare

Siç evidentohet në grafik, operatorët e tjerë zotërojnë pjesë më të madhe tregu të totalit të shërbimit jouniversal postar sesa Posta Shqiptare.

II.2 Ndarja e tregut të shërbimit postar ekspres


Sipas ligjit nr. 46/2015, “Shërbim ekspres” është shërbimi i shpërndarjes “derë më derë”, në një kohë të shkurtër, i shpërndarjes një ditë pas dorëzimit, ose transportit në kohë të përcaktuar të objektit postar që përfshin shpërndarjen e dokumenteve, pakove dhe mallrave. “Shpërndarje” është procesi i përpunimit në qendrën e shpërndarjes për dorëzimin e objekteve postare në destinacion.

Grafik 3. Shërbimi ekspres Posta Shqiptare vs. Operatorët e tjerë



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare


Grafik 4. Shërbimi ekspres, mbulimi i tregut Ekspres brenda vendit vs. Ekspres ndërkombëtar



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Bazuar në të dhënat e grafikut të mësipërm rezulton se në shërbimin ekspres dominojnë operatorët e tjerë kundrejt Postës Shqiptare. Në shërbimin postë ekspres brenda vendit, operatorët e tjerë postarë zënë më shumë se 80% të tregut krahasuar me më pak se 20% që zotëron Posta Shqiptare. Gjithashtu, edhe në shërbimin ekspres ndërkombëtar zotërojnë mbi 90% të totalit të këtij shërbimi ndaj më pak se 10% të Posta Shqiptare sh.a..


Grafik 5. Shërbimi ekspres, mbulimi i tregut Posta Shqiptare vs Operatorë të tjerë



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Siç vihet re në këtë grafik, pesha kryesore e tregut të shërbimit ekspres zotërohet nga operatorët e tjerë, që varion nga 84% -90% të totalit.

Grafik 6. Shërbimi ekspres në total, ecuria në vite




Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Nga grafiku i mësipërm vihet re se shërbimi ekspres ka pasur rritje nga viti 2020 në vitin 2021 me 18%, dhe rënie me 12% në vitin 2022. Nga viti 2022 deri në vitin 2024, volumi i shërbimit ekspres ka pësuar rritje rreth 36%.


Bazuar në VKM¹ nr. 542, datë 27.7.2016, blerjet online të cilat kalojnë vlerën e produktit mbi 22 euro, taten me tarifë doganore dhe TVSH, me përjashtim të alkoolit, duhanit dhe parfumeve, të cilat taten në çdo rast, pavarësisht vlerës së blerjes, pra edhe nëse ajo është më e vogël se 22 euro. Para vitit 2016, tarifa doganore dhe TVSH-ja zbatoheshin vetëm mbi blerjet dhe dërgesat mbi 150 euro.

Grafiku 7: Pjesët e tregut në totalin e objekteve postare 2020 - 2024



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Grafik 8. Totali i objekteve postare të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofrues të tjerë, ecuria në vite



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

¹ Për një ndryshim në vendimin nr.919, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr.102/2014, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës Së Shqipërisë”

Në grafikun e mësipërm vihet re se Posta Shqiptare në të gjitha shërbimet e ofruara, të marra së bashku ka zotëruar gjithmonë mbi 80% të tregut.

II.3 Treguesit financiarë

Bazuar në ligjin nr. 46/2015, ofruesit e shërbimeve postare, që ofrojnë shërbime postare nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm apo individual të lëshuar nga AKEP, janë të detyruar t'i japin AKEP-it, me kërkesë të tij, çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur detyrimet e tij funksionale, sipas këtij ligji.

Në veçanti, AKEP-i mund të kërkojë informacion, duke përfshirë informacione financiare, të cilat janë të nevojshme:


- a) për verifikimin sistematik ose rast pas rasti të përputhshmërisë me dispozitat e këtij ligji;
- b) për qëllime statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që rrjedhin nga një marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe organizatave ndërkombëtare.

Kërkesa e AKEP-it për informacion është e arsyetuar dhe proporcionale me përmbushjen e detyrave funksionale, për të cilat ky informacion kërkohet.

II.4 Struktura e të ardhurave të tregut postar

Referuar të dhënave të raportuara për vitin 2024² nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, të ardhurat e realizuara në tregun e shërbimeve postare janë afërsisht 2.76 miliardë lekë. Pjesën më të madhe nga ofruesit e shërbimeve postare në lidhje me nivelin e të ardhurave të realizuara në treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash rreth 1.4 miliardë lekë, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total 1.36 miliard lekë. Posta Shqiptare zotëron 51% të tregut, e pasuar nga DHL Albania me 16% të tregut dhe më pas ofruesit e tjerë me rreth 33%.

Grafik 9. Pjesët e tregut bazuar në të ardhurat nga të gjithë ofruesit e shërbimeve postare



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP


² Të ardhurat dhe investimet mund të ndryshojnë në varësi të raporteve të auditimit dhe raportimit në AKEP.

Referuar të dhënave të raportuara nga ofruesi i shërbimit universal postar, Posta Shqiptare dhe ofruesit e shërbimeve postare për vitin 2024, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2.76 miliard lekë, duke shënuar një rritje me rreth 11% në krahasim me raportimet për vitin 2023. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash rreth 1.4 miliardë lekë, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total afërsisht 1.36 miliardë lekë.

Pjesa e tregut në të ardhura e Postës Shqiptare në vitin 2024 ishte rreth 51%, e cila është më e ulët krahasuar me pjesën e tregut të volumit të objekteve postare prej 80%, pjesë e konsiderueshme e të cilit e zënë objektet e zërit të shërbimit universal postar.

Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar sipas të ardhurave për periudhën kohore 2020 – 2024, në mënyrë krahasuese të ardhurat e Postës Shqiptare ndaj totalit të të ardhurave të ofruesve të tjerë të shërbimeve postare.


Grafik 10. Pjesët e tregut në të ardhura, Posta Shqiptare vs. Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Gjatë vitit 2024 vihet re se Posta Shqiptare ka shënuar rritje të të ardhurave, edhe operatorët e tjerë postarë kanë pasur rritje të të ardhurave të realizuara në krahasim me vitin 2023. Nga kjo rezulton që pesha e pjesës së tregut të të ardhurave të Postës Shqiptare ka rënë nga 55% në vitin 2023 në rreth 51% në vitin 2024.

Grafik 11. Të ardhurat e tregut të ofrimit të shërbimeve postare (milionë lekë)



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Bazuar në të dhëna e grafikut më sipër në lidhje me të ardhurat totale të gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve postare, rezulton se në vitin 2024 evidentohet një rritje e nivelit të të ardhurave me rreth 11%. Ndërsa në vitin 2023 ka pasur një rritje me 10% në krahasim me vitin paraardhës 2022, vit ky i cili paraqet edhe nivelin më të ulët të të ardhurave të raportuara nga ofruesit e shërbimeve postare përgjatë periudhës së marrë në analizë.

Të ardhurat e Posta Shqiptare sh.a.

AKEP, në zbatim të kërkesave të rregullores nr. 40, datë 17.12.2015, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”, e ndryshuar, mbledh të dhëna statistikore dhe financiare nga ofruesi i shërbimit universal postar Posta Shqiptare sh.a., dhe ofruesit e shërbimeve postare.

Në tabelën në vijim paraqiten treguesit e të ardhurave të gjeneruara nga Posta Shqiptare, përcaktuar si ofrues i shërbimit universal me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP.


Tabela 4. Të ardhurat e gjeneruara në vite sipas shërbimeve të ofruara (në lekë)

Vitet	Shërbimi Universal	Shërbimi Jouniversal	Shërbimi Ekspres	Total
2020	1,287,846,420	11,341,034	189,846,996	1,489,034,450
2021	1,227,227,262	19,236,738	207,946,000	1,454,410,000
2022	1,272,897,800	24,651,510	110,761,885	1,408,311,196
2023	1,188,652,077	20,092,830	173,396,913	1,382,141,820
2024	1,176,898,228	94,102,165	124,468,729	1,395,469,122

Burimi: Të dhëna të raportuara nga Posta Shqiptare.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën sa më sipër, vërehet se të ardhurat totale të Postës Shqiptare përgjatë periudhës 2020 – 2023 kanë shënuar rënie të vazhdueshme duke arritur në rreth 7% krahasuar me vitin 2020, sikundër në vitin 2024 të ardhurat totale të Postës Shqiptare i janë rikthyer rritjes, rritje e cila vlerësohet në kufirin rreth 1% krahasuar me vitin 2023.

Grafik 12. Pësia në të ardhurat e Postës Shqiptare sipas shërbimeve të ofruara




Burimi: Të dhëna të raportuara nga Posta Shqiptare.

Siç vihet re nga të dhënat e grafikut të mësipërm rezulton se për Postën Shqiptare burimi kryesor i të ardhurave të realizuara nga ofrimi i shërbimeve postare (pa përfshirë të ardhurat nga shërbimet financiare) është shërbimi universal postar i cili, përgjatë gjithë periudhës së marrë në analizë, luhet në kufijtë 84 – 90% % të të ardhurave totale, i ndjekur nga shërbimi ekspres dhe shërbimi jouniversal postar.

II.5 Investimet në sektorin postar

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e të ardhurave dhe investimeve në sektorin postar në vitet 2020-2024. Në vitin 2024, totali i investimeve në sektorin postar ishte rreth 300 milionë lekë, me një rritje prej rreth 6% në krahasim me vitin 2023.

Grafik 13. Të ardhurat dhe investimet në total, ecuria në vite



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Në tabelën në vijim paraqitet vlera e investimeve të kryera nga Posta Shqiptare kundrejt investimeve të raportuara nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Tabela 6. Investimet në vite nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë

Viti	Investimet (në mijë lekë)	
	Posta Shqiptare	Ofruesit e Tjerë
2020	334,711	28,083
2021	265,956	393,534
2022	87,020	42,808
2023	42,246	240,233
2024	137,334	161,969

Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare


Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër vërehet se, në vitet 2020 dhe 2023, Posta Shqiptare ka investuar ndjeshëm më shumë se të gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, ku vlen të evidentohen investimet e kryera në vitin 2020 që përkojnë edhe me periudhën pandemike të shkaktuar nga COVID-19, gjatë së cilës shërbimet postare morën një rol mjaft të rëndësishëm. Nëse krahasohen të dhënat për investimet në total përgjatë periudhës së marrë në analizë 2020 – 2024, vërehet se vlera totale e investimeve të postës shqiptare është pothuajse e barabartë me totalin e investuar nga të gjithë ofruesit e shërbimeve postare së bashku.

III. Treguesit Teknik dhe të Rrjetit

Bazuar në ligjin nr. 46/2015, AKEP, harton dhe miraton standardet dhe kushtet teknike për ofrimin e shërbimit postar, në përputhje me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare, përfshirë standardet për ofrimin e shërbimit universal postar.

Ofrimi i shërbimeve postare, bëhet në përputhje me standardet e harmonizuara evropiane dhe standardet ndërkombëtare për shërbimet postare, të përcaktuara nga UPU. Në rrjetin postar mund të vendosen vetëm pajisje që kanë karakteristika teknike, sipas standardeve të harmonizuara e të miratuara nga organizmat ndërkombëtarë, ku Republika e Shqipërisë aderohet. Informacioni mbi standardet e aplikueshme për shërbimet postare publikohet në faqen zyrtare të AKEP.

Grafik 14. Treguesit teknik dhe të rrjetit, ecuria në vite 2020-2024



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

III.1 Cilësia dhe standardet e realizimit të shërbimeve postare

Një nga qëllimet e ligjit nr. 46, datë 7.5.2015, është përcaktimi i standardeve të cilësisë për ofrimin e shërbimit universal, nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit, harmonizimi i standardeve teknike dhe modernizimi i shërbimeve postare.

AKEP përcakton me rregullore standardet për cilësinë e shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit me cilësi të mirë, sipas standardeve ndërkombëtare. Ofruesit e shërbimit universal postar janë të detyruar, të paktën 1 herë në vit, të publikojnë informacion për cilësinë e shërbimit universal postar. Cilësia e shërbimit përfshin, në veçanti, kërkesa për kohën e shpërndarjes së objekteve postare, sistemin e informimit për ndjekjen e objekteve postare, rregullsinë dhe besueshmërinë e shërbimeve kombëtare dhe ato ndërkufitare/ndërkombëtare. Monitorimi i cilësisë së shërbimeve kryhet nga AKEP, të paktën 1 herë në vit. Rezultatet e monitorimit publikohen në faqen zyrtare të AKEP. Në rast mosrespektimi të cilësisë së shërbimit nga ofruesi i shërbimit universal postar, AKEP njofton ofruesin e shërbimit, duke i vendosur afat për përmbushjen e detyrimeve. Në rast të konstatimit të shkeljeve të përsëritura, AKEP merr masa të përshkallëzuara, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Në bazë të nenit 64, pika 3, të ligjit nr. 46, datë 7.5.2015, AKEP ka pajisur me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar në Republikën e Shqipërisë, personin juridik “Posta Shqiptare sh.a.”.

Në bazë të rregullores nr. 36, datë 29.10.2015, “Për ofrimin e Shërbimit Universal Postar”, miratuar me VKD nr.2627, datë 29.10.2015, standardet e cilësisë për shërbimin universal postar brenda vendit të ofruar nga Posta Shqiptare janë:³

Tabela 7. Standardet e cilësisë për shërbimin universal postar brenda vendit - Posta Shqiptare

	Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje sipas afatit)
Brenda për brenda qytetit	D + 1	95%
	D + 2	5%
Ndërmjet qyteteve	D + 1	85%
	D + 2	15%
Në fshatra	D + 2	60%
	D + 3	20%
	D + 4	20%

³ D: data e depozitimit (pranimit) të objektit postar në (nga) ofruesi i shërbimit postar.

n: numri i ditëve të punës (përfshihen ditët e pushimit dhe festat zyrtare) që duhen për shpërndarjen e objektit nga data e pranimit deri në datën e dorëzimit tek i adresuari.

Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar ndërkombëtar të ofruar nga Posta Shqiptare janë:

Tabela 8. Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar ndërkombëtar - Posta Shqiptare

	Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje kumulative)
Vendet e BE (Poste Europe) dhe rajonit SEE ¹	D + 3	85%
	D + 5	97%
Vendet e Tjera (UPU):		
Vendet e Rajonit të Mesdheut (përveç vendeve të BE)	D + 5	85%
Vendet e Amerikës së Veriut	D + 6	85%
Vendet e tjera të Amerikës, Azi dhe Oqeani	D + 8	85%
Vendet Afrikës	D + 9	85%

Tabela 9. Standardet e cilësisë së Shërbimit Universal Postar 2021-2024

	Postë brenda vendit						Postë ndërkombëtare					
	Brenda për brenda qytetit		Ndërmjet qyteteve		Në fshatra		Vendet e BE (Europë)			Vendet e tjera (UPU)		
	D+1	D+2	D+1	D+2	D+2	D+3/4	D+3	D+5	D>5	D+5	D>5	
2021	97%	4%	96%	4%	84%	16%	67%	90%	0%	0%	0%	
2022	97%	4%	96%	4%	85%	15%	70%	90%	0%	0%	0%	
2023	97%	3%	97%	4%	85%	15%	70%	90%	0%	0%	0%	
2024	96.8%	3.2%	96.5%	3.5%	85.3%	14.7%	85%	10%	5%	0%	0%	

Në bazë të rregullores nr. 38, datë 19.11.2015, “Për Autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e Shërbimeve Postare”, miratuar me VKD nr. 2643, datë 19.11.2015, ofrimi i shërbimeve postare duhet të realizohet në përputhje me standardet evropiane dhe ato botërore për shërbimet postare, si dhe me standardet e përcaktuara nga AKEP në këtë rregullore.

Standardet e cilësisë për shërbimin postar brenda vendit të ofruar nga ofruesi i shërbimit postar janë:

Tabela 10. Standardet e cilësisë së shërbimeve postare ekspres – postë brenda vendit

Detyrimet e cilësisë së shërbimeve postare ekspres – brenda vendit			
Brenda për brenda qytetit/ Ndërmjet qyteteve		Në zonat rurale	
Koha e dorëzimit	Objekte postare të dorëzuara	Koha e dorëzimit	Objekte postare të dorëzuara
D + 1	95 %	D + 2	5 %

Për dërgesat ekspres të postës së jashtme, merren në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimit postar të ofruesve të shërbimit postar me të cilat është lidhur marrëveshje.


Ofruesi i shërbimit postar ka detyrimin e plotësimit të standardeve të mëposhtme të shërbimit postar të CEN të transpozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) e Shqipërisë:

- S SH EN 13850:2012:** Shërbimi postar – Cilësia e shërbimit – Matja e kohës së tranzitit të shërbimeve nga fillimi në fund (end-to-end) për pjesë të veçanta të dërgimit prioritar me postë dhe dërgimi me postë i klasit të parë;
- S SH EN 14508:2006:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për një pjesë jo prioritare të dërgimit me postë dhe dërgimi me postë i klasit të dytë;
- S SH EN 14534:2006:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për dërgesat me postë me grumbuj të pa ambalazhuar.

III.2 Të punësuarit

Sektori postar është sektor i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare dhe përbën një nga sektorët me numrin më të madh të punonjësve në vend, ku për vitin 2024, raportohet se janë punësuar rreth 3.300 punonjës, nga të cilët rreth 56% janë femra.

Grafik 15. Numri i të punësuarve Posta Shqiptare vs. Ofruesit e tjerë, ecuria në vite



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Gjatë vitit 2024, bazuar në raportimet e operatorëve postarë rezulton se numri i të punësuarve në sektorin postar është 3,297 punonjës, duke u rritur me 144 punonjës krahasuar me vitin 2020. Rritjen më të madhe e ka shënuar Posta Shqiptare me 93 punonjës. Posta Shqiptare vijon të jetë ofruesi i shërbimeve postare me pjesën më të madhe për sa i përket treguesit të punësim dhe pesha e saj, përkundërt ofruesve të tjerë të shërbimeve postare, luhatet në nivelet 76%-80% në periudhën 2020-2024.

III.3 Ankesat e pranuar dhe të zgjidhura

Bazuar në ligjin nr.46/2015, ofruesit e shërbimeve postare hartojnë kushtet e përgjithshme dhe termat e ofrimit të shërbimeve postare, të cilat në veçanti, përmbajnë edhe procedurat për zgjidhjen e ankesave.

Çdo përdorues i shërbimeve postare ka të drejtë të ankohet apo të kërkojë sqarime tek ofruesi i shërbimit postar, në rast se vëren shkelje në përmbushjen e termave dhe kushteve të përgjithshme të ofrimit të shërbimit postar, të tarifave të ofruara nga ofruesi i shërbimit postar, si dhe të cilësisë së shërbimit të ofruar.

Përdoruesi i shërbimit postar mund të paraqesë ankimin me shkrim brenda 30 ditëve:

- a) nga ofrimi i shërbimit, nëse ankesa i referohet cilësisë së shërbimit të ofruar;
- b) nga marrja e faturës për shërbimin e ofruar, nëse ankesa i referohet shumës së faturuar për shërbimin e ofruar.


Pas marrjes së ankesës, ofruesi i shërbimit postar duhet të verifikojë ankesën e bazuar në pikën 3 të nenit 37 dhe, pas verifikimit, të kthejë një përgjigje jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së ankesës nga përdoruesi i shërbimit postar.

Nëse përdoruesi nuk është dakord me përgjigjen me shkrim të ofruesit të shërbimit postar, atëherë përdoruesi fillon procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sipas nenit 55, të ligjit nr.46/2015.

Çdo ofrues i shërbimit postar është i detyruar të publikojë në faqen zyrtare të tij dhe në zyrat e ofrimit të shërbimit, rregullat për pranimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve, sipas ligjit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e numrit të ankesave të pranuar dhe të zgjidhura nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë në periudhën 2018 – 2024.

Grafik 16: Ankesat e pranuar vs. të zgjidhura, ecuria në vite



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Nga të dhënat e raportuara rezulton se, për vitin 2024, numri i ankesave ka qenë 1,303 dhe të gjitha rezultojnë të zgjidhura. Ndërsa shuma e dëmit të kompensuar shkon rreth 1,550,088 lekë.

Në periudhën 2020-2024 në AKEP janë depozituar në total vetëm 8 ankesa nga përdoruesit e shërbimit postar, prej të cilave 5 ankesa në vitin 2021 dhe 3 ankesa në vitin 2024. Në vitin 2021, 2 ankesa ishin për ofruesin e shërbimit universal postar Posta Shqiptare, dhe 3 ankesa për ofrues të shërbimeve postare (jouniversal/ekspres) DHL UPS Albania dhe FedEx.

Në vitin 2024 në AKEP u depozituan 3 ankesa nga përdorues të shërbimit postar, prej të cilave 2 ankesa ishin në lidhje me shërbimin postar të ofruar nga United Transport dhe me tregtinë elektronike dhe 1 ankesë ishte në lidhje me humbjen e një objekti postar ndërkombëtar nga Posta Shqiptare. Një ankesë e lidhur me mosdorëzimin e objektit postar/mallit të porositur online u zgjidh miqësisht midis ofruesit të shërbimit dhe ankimuesit nëpërmjet kompensimit/rimbursimit të ankimuesit/palës marrëse të objektit postar të porositur online, pa kaluar në procedurë formale Zgjidhje Alternative e Mosmarrëveshjes (ZAM), ndërsa 2 ankesat e tjera u trajtuan me procedurë nga Komisioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes (KZM) e AKEP.

IV. Ofrimi i shërbimi universal postar nga Posta Shqiptare

IV.1 Autorizimi individual për shërbimin universal

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.46 datë 7.5.2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, AKEP, me vendimin nr.13, datë 30.6.2020, i ka dhënë Postës Shqiptare autorizimin individual, si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar, me afat pesëvjeçar.

Ofruesi i Shërbimeve Postare “Posta Shqiptare” sh.a., me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 13, datë 30.6.2020, është i pajisur me Autorizimin Individual, si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar, me afat pesëvjeçar dhe me Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit nr. 2015-APSH-0018, datë 5.1.2016, për ofrimin e shërbimeve postare sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Ky afat mbaron në 7 korrik 2025 dhe për këtë arsye AKEP, bazuar në pikën 3, të nenit 13, të këtij ligji, ka filluar procedurën e analizës së tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimin nëse ka më shumë se një ofrues të mundshëm të shërbimit universal postar.

Bazuar në ligjin nr. 46/2015, çdo përdorues në Republikën e Shqipërisë gëzon të drejtën e shërbimit universal postar, që përfshin ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit postar me një cilësi të përcaktuar në rregulloren e miratuar nga AKEP-i dhe me çmime të përballueshme në të gjitha pikat e aksesit brenda territorit të tyre.

- a. Nëse ka apo jo zona të pambuluara me shërbim nga ofruesi ekzistues i shërbimit universal postar;

Nga raportimi i ofruesit të shërbimit universal, rezulton se gjatë vitit të fundit 2024 Posta Shqiptare ka 535 zyra postare për të mbuluar me shërbim gjithë zonat gjeografike;

- b. Nëse ka apo jo elemente të shërbimit universal të paofruara nga ofruesi ekzistues i shërbimit universal postar.

Posta Shqiptare ofron të gjithë elementët e shërbimit universal ku përfshihen objektet postare si:

✓ **Letrat**

Konsiderohet “letër” çdo komunikim i shkruar që përbën një korrespondencë zyrtare ose personale, e mbyllur në zarf, i cili ka formën e një drejtkëndëshi. Mbi zarf nga ana e përparme e tij, në të djathtë shkruhet adresa e marrësit, ndërsa në pjesën e përparme në të majtë shkruhet adresa e dërguesit.

Adresa e marrësit dhe e dërguesit duhet të jetë e plotë dhe e saktë, e lexueshme, e shkruar me germa kapitale romake dhe shifra arabe. Letrat pranohen me peshë deri në 2 kg, si për brenda ashtu edhe për jashtë vendit.

✓ **Paketat e vogla**

Quhen “paketa të vogla” objektet që përmbajnë sende të ndryshme në sasi të vogël, prodhime artistike, disqe gramafoni, shirita manjetike, cigare, mostra tregtie, ose ndonjë send tjetër që shërben si mostër, pjesë këmbimi aparaturash etj. Në këto paketa nuk lejohen të futen kartëmonedha ose sende të tjera me vlerë.

Duhet t’i kushtohet rëndësi ambalazhimit të paketës, i cili duhet të jetë i përshtatshëm për formën dhe përmbajtjen e saj. Pesha e paketës duhet të jetë deri në 2 kg, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

✓ **Kartë postare**

Kartë – postare, mund të jetë e thjeshtë, e përbërë prej kartoni të hollë ose prej letre të trashë 90x140mm dhe kartë postare me përgjigje të paguar, e cila përbëhet nga dy karta postare të thjeshta të palosura njëra mbi tjetrën, me ndryshim që ajo e poshtmjka ka të shkruar mbishkrimin “Përgjigje e Paguar”.

Njëra anë e kartës postare të thjeshtë është e pastër, ku dërguesi mund të shkruajë korrespondencën, adresën e marrësit. Për sa i përket kartës postare me përgjigje të paguar, kjo e fundit i dorëzohet marrësit pa u shkëputur pjesët e saj.

✓ **Cekogramet (objekte postare për të verbrit)**

Cekogramet, janë korrespondenca për të verbrit, të cilët sipas legjislacionit në fuqi për statusin e të verbërve, udhëzimit nr. 4038, datë 4.9.2015 të MIE, dhe rregullave të UPU-së, përfitojnë shërbim postar falas. Objektet postare për të verbrit përfshijnë:

- korrespondencën, literaturën për të verbrit dhe pjesërisht të verbrit të çfarëdo lloj formati (edhe regjistrimet me zë);
- pajisje apo materiale të çfarëdo lloji të përshtatura për të ndihmuar personat e verbër dhe pjesërisht të verbër në lehtësimin e problemeve të shikimit.

Kufiri i peshës për këtë kategori objektesh, si për brenda ashtu dhe për jashtë vendit është 7kg.


✓ **Ftesat, komunikimet dhe lajmërimet gjyqësore**

Ftesat, komunikimet dhe lajmërimet gjyqësore janë objekte të cilat dërgohen nga institucionet e drejtësisë, në zarfe ose të hapura, dhe trajtohen si objekt i porositur. Këto objekte përbëhen nga dy pjesë, pjesa e parë zë vendin e lajmërim marrjes dhe e dyta i dorëzohet marrësit.

IV.2 Plotësimi i detyrimeve nga posta shqiptare për shërbimin universal

Në zbatim të ligjit nr. 46/2015, kreu i VII, neni 33 “Cilësia e shërbimit” dhe rregullores “Për ofrimin e shërbimit Universal Postar”, miratuar me vendimin nr. 2627, datë 29.10.2015 të KD të AKEP, kreu VIII , neni 31 “Standardet e cilësisë së ofrimit të Shërbimit Universal”, Posta Shqiptare sh.a., ka raportuar çdo vit pranë AKEP-it mbi realizmin e treguesve të cilësisë së ofrimit të shërbimit universal.


Grafik 17. Cilësia dhe standardet shërbimit universal postar, viti 2024



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Tabela në vijim paraqet informacion mbi treguesit teknik të rrjetit postar të Postës Shqiptare dhe ofruesve të tjerë për vitin 2024.

Grafik 18. Treguesit teknik dhe të rrjetit për çdo ofrues të shërbimeve postare, viti 2024



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Me shkresën nr. 629 prot, datë 1.4.2025, Posta Shqiptare ka dërguar raportin mbi cilësinë e shërbimit postar universal gjatë vitit 2024. Nëpërmjet kësaj shkrese, Posta Shqiptare ka raportuar për çdo filial objektivat vjetore të treguesve të cilësisë të shërbimit universal postar, në përputhje me standardet sipas nenit 30, “Lista e standardeve për matjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit universal postar” të rregullores “Për ofrimin e Shërbimit Universal Postar”.

Për çdo filial, planifikimi i treguesve të cilësisë të shërbimit universal, u bazua në treguesit teknikë si më poshtë vijon:

- Në realizimin e treguesve të cilësisë të shërbimit universal të vitit të mëparshëm, në realizimin e volumit të objekteve postare të shërbimit universal postar të pranuar dhe shpërndarë nga zyrat postare qytet, njësi administrative, fshat;
- Në rishikimin e grafikëve të brendshëm të grumbullimit, përpunimit, vijimit të objekteve postare të shërbimit universal dhe shpërndarja e tyre sipas destinacionit;
- Në masat e marra nga kontrollet periodike në filiale dhe degë në varësi në lidhje me përmirësimet në organizimin e brendshëm të punës brenda zyrës postare, sektorëve të shërbimeve të degëve dhe filialeve.

Treguesit e performancës së cilësisë së shërbimit universal postar për vitin 2024

Në tabelën në vijim paraqiten në mënyrë të përmblëdhur objektivi dhe realizimi i cilësisë së shërbimit universal postar në filialet e Postës Shqiptare, për të tre standardet, shpërndarje brenda qytetit, ndërmjet qyteteve dhe ndërmjet fshatrave.

Nr	Filiali	Objektivi i treguesit të Performancës brenda qytetit standardi (95%)	Realizimi i treguesit të Performancës brenda qytetit standardi(95%)	Objektivi i treguesit të Performancës ndërmjet qyteteve standardi(85%)	Realizimi i treguesit të Performancës ndërmjet qyteteve standardi(85%)	Objektivi i treguesit të Performancës ndërmjet fshatrave standardi(60%)	Realizimi i treguesit të Performancës ndërmjet fshatrave standardi(60%)
		D+1%	D+1%	D+1%	D+1%	D+2%	D+2%
1	Tiranë	96.70%	96.30%	94.30%	93.00%	78.50%	80.80%
2	Durrës	96.20%	99.00%	97.50%	96.70%	87.70%	92.20%
3	Elbasan	98.20%	98.50%	96.50%	95.50%	78.10%	81.70%
4	Shkodër	97.70%	98.60%	95.10%	97.50%	78.00%	94.60%
5	Lezhë	97.80%	97.70%	96.00%	96.80%	79.20%	92.40%
6	Fier	97.40%	97.50%	96.00%	95.20%	81.10%	88.60%
7	Vlorë	97.80%	96.60%	94.60%	98.80%	77.90%	88.30%
8	Lushnjë	97.80%	100%	97.70%	98.20%	87.60%	92.80%
9	Berat	97.00%	96.20%	95.30%	96.80%	78.80%	88.70%
10	Korçë	98.30%	100%	94.00%	98.90%	77.10%	89.90%
11	Gjirokastër	97.70%	97.10%	94.70%	97.60%	76.00%	79.10%
12	Sarandë	96.90%	96.50%	91.00%	93.30%	77.90%	88.10%
13	Mat	95.10%	96.40%	88.00%	90.30%	72.30%	83.40%
14	Kukës	95.00%	96.80%	92.00%	99.30%	72.20%	91.80%
	TOTALI	96.50%	96.80%	94.80%	96.50%	78.70%	85.30%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare

Siç vërehet nga tabela sa më sipër, treguesi i performancës së cilësisë së shërbimit universal postar brenda qytetit për periudhën janar - dhjetor 2024 është realizuar 96.8% në D+1 nga 95% që është standardi i miratuar me rregullore të AKEP.

Treguesi i performancës së cilësisë së shërbimit universal postar ndërmjet qyteteve për periudhën janar - dhjetor 2024 është realizuar 96.5% në D+1 nga 85% që është standardi i miratuar me rregullore të AKEP.

Treguesi i performancës së cilësisë së shërbimit universal postar ndërmjet fshatrave për periudhën janar - dhjetor 2024 është realizuar 85.3% në D+2 e cila është dukshëm më e lartë se 60% që është standardi i miratuar me rregullore të AKEP.

Pjesëmarrja në testet G.M.S. të organizuara nga UPU –ja

Posta Shqiptare mori pjesë në projektin G.M.S. (Global Monitoring System) të organizuar nga UPU-ja, për matjen e cilësisë së shërbimit universal postar nëpërmjet testeve të vazhduara në formatin e thjeshtë për ciklin 2022-2024. Shkëmbimi i testeve të vazhduara të këtij moduli u kryen me pesë operatorë postarë pjesëmarrës në këtë projekt, të kategorizuar sipas tre niveleve gjeografike:

- ✓ Brenda rajonit: Kroaci, Turqi (Evropa Jugore);
- ✓ Ndër rajonal: Bullgari (Evropa Lindore);

- ✓ Ndër kontinental: Kanada, Singapor (Amerika Veriore dhe Azi).

Pjesëmarrja në këtë projekt e Posta Shqiptare sh.a., kishte si qëllim matjen e treguesve të cilësisë së shërbimeve postare universale për objektet test të formatit letër e thjeshtë. Për periudhën janar - dhjetor 2023, sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi G.M.S. STAR, të monitoruar nga UPU-ja, standardi i shpërndarjes për objektet postare të hyra ndërkombëtare është 85% dhe rezultoni se në Shqipëri është realizuar 86%.

IV.3. Monitorimi i kriterëve të shërbimit universal

Bazuar në nenin 60 e vijues të Ligjit Nr. 46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, (ligji Nr. 46/2015), nenin 45 të ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe Rregulloren Nr. 45, datë 27.10.2016 “Metodikë Inspektimi i veprimtarisë së ofruesve të Shërbimeve Postare”, AKEP ka kryer çdo vit inspektimet pranë Posta Shqiptare SHA “Për Ofruesin e Shërbimit Universal Postar”.

Gjithashtu, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Rezolutën nr. 1581/2 prot., datë 04.07.2024, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2023”, ka përcaktuar disa Rekomandime sipas të cilave AKEP, si autoritet i pavarur dhe mbikëqyrës në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare duhet:

- AKEP gjatë inspektimeve që do të zhvillojë pranë ofruesit të shërbimit universal “Posta Shqiptare” të vijojë të kërkojë përmbushjen e detyrimit për shpërndarjen e objekteve postare në adresën e marrësit krahas implementimit të projektit për vendosjen e kutive postare pranë degëve të postës me kod unik, ku qytetarët mund të tërheqin pakot në çdo orë nëpërmjet një kodi specifik, duke evituar edhe qëndrimet në radhë të qytetarëve për tërheqjen e pakove, problem i cili është bërë shqetësues veçanërisht në Tiranë.*
- Lidhur me rekomandimet e AKEP për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare (pako/kolipostë) në adresën e marrësit, në përputhje me nenin 40 të Ligjit 46/2015, brenda vitit 2024;*

Manuali i Konventës së UPU-së në Nenin 17-205 (Procedurat e Shpërndarjes) citon: “Si rregull i përgjithshëm, pakot u dorëzohen të adresuesve sa më shpejt të jetë e mundur dhe sipas dispozitave në fuqi në vendin e destinacionit. Kur pakot nuk dorëzohen në adresën e marrësit, nëse kjo është e pamundur, marrësi do të njoftohet për ardhjen e tyre pa vonesë”, ndërsa legjislacioni vendas duke iu referuar citimit të mësipërm, Neni 40 i ligjit nr. 46/2015 citon: “Objektet postare dorëzohen në njërin nga këto adresa të marrësit:

- a) në banesën e tij;*
- b) në ambientet e punës ose biznesit;*
- c) në kutinë postare të vendosur në ambientet përkatëse”.*

Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se AKEP-i, si autoriteti rregullator kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, monitoron në

mënyrë permanente veprimtarinë e ofruesit të shërbimit universal postar “Posta Shqiptare” sh.a.

Në vijim të inspektimeve të kryera tek Posta Shqiptare sh.a., është kërkuar respektimi i detyrimit për dorëzimin e pakove në adresë të marrësit, në përputhje me standardet dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacion. Nga inspektimi i fundit, i kryer në muajin dhjetor 2024, është konstatuar se ka pasur rënie të numrit të objekteve të dala për dorëzim në adresë.

Faktorë që kanë ndikuar në këtë rënie janë: mungesa e mjeteve të transportit për shkak të procedurave të prokurimit për blerjen e makinave dhe motorëve, në kushtet e përfundimit të kontratës së leasing, si dhe arsytet që kanë të bëjnë me adresat e paplota të marrësve, apo preferencave të vetë klientëve për t’i tërhequr pakot në zyrat postare. Gjithsesi, mbetet ende i lartë numri i dërgesave që nuk dorëzohen në adresë, veçanërisht në qytetin e Tiranës, pasi arsye kryesore mbetet fakti se adresa e marrësit është e paplotë (me vetëm një element). Referuar raportimeve të Postës Shqiptare për vitin 2024, përqindja e dorëzimit në adresë kundrejt paketave dhe kolive të dala për dorëzim në adresë është në masën 43.1%.

Në këtë kuadër, Posta Shqiptare sh.a., ka vijuar me masa të menjëhershme për të rritur kapacitetet logjistike dhe për të përmirësuar procesin e verifikimit dhe regjistrimit të adresave të sakta të klientëve, në mënyrë që të garantohet ofrimi i një shërbimi në përputhje me standardet dhe pritshmëritë. Aktualisht, ka përfunduar procedura e prokurimit për 55 motorë me tre rrota 100% elektrikë, të cilët do të vihen në përdorim në fund të 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Për të përmirësuar shërbimin ndaj qytetarëve dhe për të ofruar kualitet dhe besueshmëri në tregun postar, së fundmi Posta Shqiptare ka investuar në vënien në punë të një produkti novator, siç janë dhe kutitë postare elektronike, ku aktualisht po vihen në funksionim 13 kuti postare elektronike, me 313 sirtarë në 10 filiale të saj. Kutitë postare elektronike të sigurta (bankomat postar) do t’i shërbejnë kryesisht një target grupi të caktuar konsumatorësh të tregtisë online.

Për sa më sipër, nga ana e AKEP i është lënë si rekomandim subjektit “Posta Shqiptare” sh.a, që të dorëzojë raportime periodike 3 (tre) mujore mbi dorëzimet në adresë të dërgesave postare. Në funksion të realizimit të këtij shërbimi, bazuar në deklaratimet e “Posta Shqiptare” SHA për vitin 2024 ofruesi i shërbimit universal ka raportuar se për flotën e transportit disponon 61 furgona, 10 vetura dhe 97 motoçikleta, të cilat janë shpërndarë në të gjitha filiale të postave.

Lidhur me plotësimin e kërkesave të nenit 31 të Ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores Nr. 41 datë 03.03.2016 “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”.

Për plotësimin e kësaj kërkesë ligjore “Posta Shqiptare” SHA ka sqaruar se ka ndërmarrë disa masa konkrete për plotësimin e kërkesave të nenit 31, të Ligjit nr.46/2015, si:

- a. Identifikimi dhe regjistrimi i të gjithë zërave të shërbimit postar universal përfshirë objektet e thjeshta me ndarjet përkatëse sipas zërave dhe të ardhurave për secilin zë;
- b. Implementimi i regjistrimit në një llogari specifike në kontabilitet e të ardhurave nga shërbimi universal postar nëpërmjet raporteve mujore;

- c. Realizimi i përllogaritjes së pagave të punonjësve sipas vendit të punës në të gjitha degët dhe filialet e shoqërisë.

Posta Shqiptare SH.A ka theksuar se po vijon implementimin e sistemit të llogaritjes së kostos së shërbimeve universale dhe përmbushjen e detyrimeve të nenit 31 të ligjit nr.46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, AKEP për vitin 2024, në përfundim të procedurave inspektuese i ka rekomanduar “Posta Shqiptare” SHA të vijojë punën me qëllim realizimin e plotë të kërkesave të nenit 31 të Ligjit Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores Nr. 41 datë 03.03.2016 “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”.

Në raportin e veprimtarisë së AKEP për vitin 2024 është vlerësuar vullneti dhe hapat konkretë të ndërmarra nga ofruesi i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare” sh.a., në plotësimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme dhe rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Gjithsesi, është konstatuar se për plotësimin e kërkesave të nenit 31 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe rregullores nr. 41, datë 3.3.2016, “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të Shërbimit Universal Postar”, nga ky subjekt kërkohet angazhim i mëtijshëm, rritje e investimeve në fushën teknologjike deri në përmbushjen plotësisht të këtij rekomandimi. Lidhur me masat për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të Shërbimit Universal Postar, “Posta Shqiptare” sh.a., procesi është në vijim.

IV.4. Tarifat e Shërbimit Universal Postar

Tarifat aktuale të shërbimeve postare që janë pjesë e shërbimit universal postar të ofruar nga Posta Shqiptare Sh.a. janë të miratuara me VKM nr.446, date 22.09.2002, “Për miratimin e tarifave postare të shërbimeve baze”, dhe nuk kanë qenë objekt i rishikimeve/ndryshimeve prej vitit 2002. VKM 446/2002 është miratuar bazuar në përcaktimet e Ligjit nr.8530, datë 23.09.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, dhe ka përcaktuar tarifat (maksimale) të shërbimeve baze postare, që ofrohen nga operatori publik postar Posta Shqiptare sh.a., duke kryer një sërë ndryshimesh (rritje deri në dyfishim) të tarifave të mëparshme të miratuara me VKM nr. 454, date 23.9.1999.

Ligji 8530/1999 është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe sipas përcaktimeve të ligjit të ri, rregullimi i tarifave të shërbimit universal postar kryhet me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, pra jo me Vendim të Këshillit të Ministrave sipas kuadrit të mëparshëm ligjor. Megjithatë, sipas pikës 1 të nenit 64 të Ligjit 46/2015, Vendimet e Këshillit të Ministrave të dala në zbatim të Ligjit 8530/1999 (pra dhe VKM 446/22.09.2002), mbeten në fuqi deri në daljen e vendimeve në përputhje me përcaktimet e këtij ligji (46/2015).

Sipas përcaktimeve të Nenit 29 të Ligjit 46/2015, AKEP ka të drejtë të zbatojë rregullimin e tarifave, nëpërmjet një vendimi për rregullimin e tarifave të shërbimit universal postar të ofruara nga ofruesi i SHU, kur konstaton se ato nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Dy nga parimet kryesore të tarifave të SHU postar janë që ato të jenë të përballeshme si dhe të jenë të

orientuara drejt kostos dhe të sigurojnë nxitje për ofrimin efikas të shërbimit universal postar, dhe në vlerësimin e tarifave të SHU postar AKEP merr në konsideratë dhe tarifatat mesatare në vendet e BE-së dhe rajonit.


Me hyrjen në fuqi të Ligjit 46/2015, AKEP në Raportin vjetor 2015 ka bërë një krahasim të tarifave të SHU të Posta Shqiptare me tarifatat mesatare në vendet e BE dhe rajonit si dhe ecurinë e tarifave të shërbimeve postare në vendet e BE në periudhën 2004-2011. Në vitin 2022 AKEP ka bashkëpunuar me MIE në kuadër të draftimit të strategjisë së re të sektorit postar dhe “Dokumenti i politikës së shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, 2021 e në vijim”, i miratuar me VKM Nr.207, datë 6.4.2022, ka përfshirë një vlerësim/krahasim të tarifave të PSH me tarifatat mesatare në vendet e BE dhe rajonit, përfshirë ecurinë e tarifave mesatare në BE/rajon në periudhën 2013-2018, duke u bazuar në dokumentin e ERGP (Grupi i Rregullatorëve Evropianë Postarë): *ERGP PL II(19) 37 Report on postal core indicators*.

Në vijim të këtyre proceseve, AKEP në seksionet e mëposhtme ka bërë një krahasim të tarifave të Postës Shqiptare me tarifatat në vendet e BE/rajonit, duke përdorur si referencë dokumentin më të fundit të ERGP: *Report on Core Indicators for Monitoring The European Postal Market (ERGP (24) 8 Report on Postal Core Indicators, 12 February 2025)*, i cili përmban informacion për tarifatat e aplikuar në 32 vende të ERGP në periudhën 2019-2023 për objektet postare të përkufizuara si më poshtë:

- *Letër brenda vendit prioritare (20g domestic priority letter)*: Letër me peshë deri në 20g dhe kohë dorëzimi D+1;
- *Letër ndërkombëtare prioritare (20g international priority letter)*: Letër me peshë deri në 20g, me destinacion në zonën e parë ndërkombëtare në Evropë, dhe kohë dorëzimi D+3;
- *Pako brenda vendit (2kg domestic parcel)*: Pako 2kg me kohë dorëzimi D+3 (përfshihet dhe track and trace nga viti 2023 e në vijim)
- *Pako ndërkombëtare (2kg international parcel)*: Pako 2 kg, me destinacion në zonën e e parë ndërkombëtare në Evropë, me kohë dorëzimi D+5.

Në figurat e mëposhtme AKEP ka paraqitur trendin e tarifave mesatare të objekteve postare në vendet e BE dhe jo-anetare të BE (ku përfshihen dhe disa vende të rajonit si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia) në periudhën 2019-2024 sipas grafikëve të ERGP në dokumentin ERGP (24) 8 Report on Postal Core Indicators, 12 February 2025), duke shtuar në këto grafikë dhe tarifatat përkatëse të aplikuar nga Posta Shqiptare.

Grafik 19: Krahاسimi i nivelit dhe strukturës së disa tarifave të SHU në Shqipëri dhe mesataret e BE/rajonit



Shënim: Për objektet postare ndërkombetare letër dhe pako të ofruar nga Posta Shqiptare janë referuar dy tarifa: tarifa postare për transport tokësor që janë të rregulluara sipas VKM 466/2002, dhe tarifa postare për transport ajror që nuk janë përfshirë në rregullim në VKM 466/2002 dhe aktualisht nuk janë të rregulluara me vendim të AKEP sipas Ligjit 46/2015. Tarifat ndërkombetare për transport tokësor aplikohen nga PSH vetëm për objektet drejt Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

Nga krahasimi i tarifave të SHU postar të ofruar nga Posta Shqiptare dhe tarifave mesatare në vendet e BE dhe rajonit (vendet evropiane jo-anëtare të BE) në vitin 2023 rezulton se:

- **Niveli i tarifave** të PSH ka diferenca të mëdha me tarifave mesatare në vendet e ERGP/BE/Jo-BE:
 - Tarifave për letrat 20g (letra e thjeshte) brenda vendit janë 2-3 herë më të ulëta se mesataret e në vendet BE/jo-BE;
 - Tarifave për letrat 20g ndërkombëtare (transport ajror) janë rreth 30% më të ulëta se mesatarja e vendeve anëtare të BE, por në nivel mesatar me vendet jo-anëtare të BE (non-EU);
 - Tarifave për pakot 2kg brenda vendit janë 6.5 herë më të ulëta se mesatarja e vendeve anëtare të BE, dhe 2 herë më të ulëta se mesatarja në vendet jo-anëtare të BE (non-EU);
 - Tarifave për pakot 2kg ndërkombëtare (transport ajror) janë 2-2.3 më të larta se mesatarja e vendeve anëtare të BE në vendet jo-anëtare të BE (non-EU);
- **Raporti apo diferenca** në përqindje midis tarifave të objekteve postare ndërkombëtare dhe kombëtare të Posta Shqiptare është shumë më e lartë se raporti/diferenca përkatëse e tarifave mesatare të objekteve postare ndërkombëtare/brenda vendit në vendet e BE dhe jo-BE:
 - Tarifa për letër 20g ndërkombëtare (poste ajrore) e PSH është rreth 225% (3.2 herë) më e lartë se tarifa për letër brenda vendit, krahasuar me 38% në vendet anëtare të BE, dhe 69% në vendet jo-anëtare të BE (non-EU);
 - Tarifa për pako 2kg ndërkombëtare (poste ajrore) e PSH është 3900% (40 herë) më e lartë se tarifa për pako 2kg brenda vendit, krahasuar me 194% në vendet anëtare të BE, dhe 775% në vendet jo-anëtare të BE (non-EU), ku dallon Maqedonia e Veriut me një diferencë 2653% (në nivel të ngjashëm me diferencën 2400% të PSH për transport në rrugë tokësore).

Krahasimi i mësipërm i tarifave të SHU të ofruar nga PSH konfirmon problematikat e evidentuara dhe në “*Dokumentin e politikës së shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, 2021 e në vijim*”, i miratuar me VKM Nr.207, datë 6.4.2022, në faqen 13 të së cilit citohet:

Në lidhje me tarifave për ofrimin e shërbimeve postare universale konstatohet se struktura e tarifave të objekteve postare të Posta Shqiptare, ka diferenca me ato të vendeve të BE-së. Tarifa të ulëta për disa objekte postare dhe më të larta për disa të tjera, si dhe mosrishikimi i tarifave për një periudhë shumë të gjatë kohore nga viti 2002, krijojnë probleme për stimujt për ofrim efikas të shërbimit universal postar. Rishikimi periodik i tarifave për ofrimin e shërbimeve postare me qëllim rritjen e eficiencës së ofrimit të shërbimeve postare është i nevojshëm.

Adresimi i problematikave të evidentuara në lidhje me tarifave të SHU dhe pakot ndërkombëtare, nuk është objekt i këtij dokumenti, por del e nevojshme të kryhet në kuadër të procesit të rregullimit të tarifave të SHU postar, sipas përcaktimeve dhe procedurave të Ligjit 46/2015.

V. Vlerësimi i ofruesve të mundshëm të Shërbimit Universal postar

AKEP kryen procesin e rishikimit për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, sipas pikës 3, të nenit 13, të ligjit për shërbimet postare dhe në këtë dokument AKEP, analizon nëse në treg ekziston më shumë se një operator që plotëson kushtet ligjore për cilësinë e ofrimit të shërbimit universal postar në të gjithë territorin.

V.1 Baza rregullatore për analizën e tregut dhe vlerësimin e numrit të ofruesve të mundshëm të shërbimit postar

Sipas VKM nr. 239, datë 2.5.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar”, ofruesit e shërbimit universal postar përcaktohen me konkurrim publik si dhe përcaktohet zona minimale për ofrimin e shërbimit universal postar.

Përcaktimi i ofruesit/esve të shërbimit universal postar, bëhet me vendim të AKEP, bazuar në parimet e:

- a) objektivitetit;
- b) transparencës;
- c) mosdiskriminimit;
- d) proporcionalitetit.

Në përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, AKEP, garanton që ky shërbim:

1. të ofrohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
2. të kryhet sipas treguesve të cilësisë të përcaktuar;
3. të ofrohet me çmime të përballueshme;
4. të sigurojë trajtimin e barabartë të përdoruesve në të gjithë territorin e vendit.

Ofruesi i shërbimit universal postar duhet të përmbushë kërkesat ligjore për cilësinë e ofrimit të shërbimit postar, të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Për sigurimin e shërbimit universal postar, AKEP ka të drejtë të caktojë:

- a. një ose më shumë ofrues të shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit universal postar në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b. ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar për sigurimin e elementeve të veçanta të një shërbimi universal postar, nëse është e përshtatshme me kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të tregut postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezulton që këto shërbime nuk ofrohen;
- c. ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar për mbulimin e zonave të ndryshme të territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse është e përshtatshme me kushtet specifike të tregut postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezulton që këto shërbime nuk ofrohen në zonën përkatëse.

V.2 Kriteret për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar

Në përcaktimin e ofruesit/esve të shërbimit universal postar, AKEP-i në veçanti merr në konsideratë:

- a. rrethanat dhe zhvillimin e tregut të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë dhe nevojën e zbatimit të shërbimit universal postar;
- b. aftësitë teknike, përfshirë sistemin e informacionit për ndjekjen e objekteve postare, aftësitë financiare dhe besueshmërinë e ofruesit për sigurimin e shërbimit universal postar në një zonë të caktuar ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe kohore të përcaktuar;
- c. pikat e aksesit të rrjetit postar të ofruesit të shërbimit universal postar.

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të pikës 7 të nenit 6 dhe pikës 3 të nenit 12, të ligjit nr. 46, datë 7.5.2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe, bazuar në analizën e situatës aktuale për prezencën e pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar, me urdhrin nr. 469, datë 27.12.2019, ka vendosur “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar”.

Me anë të urdhrit është bërë përcaktimi i dendësisë së pikave të aksesit të rrjetit postar për ofrimin e shërbimit universal postar, duke marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve për prezencë sa më të gjerë të pikave të aksesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.


Numri i pikave të aksesit në nivel kombëtar duhet të jetë i tillë, që të sigurojë se:

a) Një zyrë postare t'i ofrojë shërbimin universal postar një numri mesatar të popullsisë prej 5,500 banorë.

Nga të dhënat statistikore për vitin 2024 rezulton se përveç Postës Shqiptare asnjë subjekt tjetër i shërbimeve postare nuk i plotëson kriteret për të pasur një zyrë postare për 5.500 banorë. Bazuar në të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2023⁴, rezulton se popullsia e Shqipërisë është 2,402,113 banorë dhe bazuar në këtë tregues çdo subjekt postar që kërkon të ofrojë shërbimin universal duhet të ketë të paktën 437 zyra postare.

⁴ <https://www.instat.gov.al/media/13615/cens-i-popullsisë-2023.pdf>

Grafik 20. Treguesit teknik të rrjetit Posta Shqiptare vs. Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga Posta Shqiptare


Sipas tabelës së të dhënave statistikore për vitin 2024 mbi treguesit teknikë të rrjetit të Postës Shqiptare dhe ofruesve të tjerë, rezulton se ky kriter plotësohet vetëm nga ana e Postës Shqiptare e cila aktualisht ka 535 zyra të shpërndara në të gjithë territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë. Siç vërehet, operatorët e tjerë së bashku kanë raportuar 269 zyra postare të hapura për publikun, numër i cili është ndjeshëm më i ulët se llogaritja prej së paku 437 zyrash për operatorë postar me qëllim mbulimin e popullsisë 1 zyrë për 5500 banorë.

b) Të ketë një zyrë postare mesatarisht në një sipërfaqe prej 53 km².

Zyrat postare (të SHU) janë pika aksesit që ofrojnë pranimin e të gjitha llojeve të objekteve postare, pjesë e objektit të Shërbimit Universal. Në çdo zyrë postare duhet të ketë të paktën 1 (një) kuti postare që shërben për pranimin e objekteve të thjeshta postare sipas përcaktimeve në rregulloret e UPU-së. Bazuar në të dhënat e raportuar nga Posta Shqiptare, rezulton se ky ofrues shërbimesh postare ka një zyrë për afërsisht 53 km² të territorit.

Në zonat urbane, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit duhet të jetë mesatarisht 5 km. Në zonat rurale, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit, duhet të jetë mesatarisht 8 km për të paktën 95% të popullsisë. Përcaktimi zonë urbane dhe zonë rurale mbështetet në klasifikimin e përdorur në Census 2011, pasi në rezultatet e CENSUS 2023 ky klasifikim nuk është bërë.

Grafik 21. Të ardhurat nga Posta Shqiptare klasifikuar SHU, shërbim jouniversal dhe ekspres



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga Posta Shqiptare


Siç vërehet në të dhëna e paraqitura në grafikun sa më sipër, peshën më të madhe të të ardhurave të gjeneruara nga Posta Shqiptare e zë shërbimi “Shërbim Universal”, me mbi 84 % për çdo periudhë, e ndjekur nga shërbimi ekspres që luhet në nivelet 8 – 14% të të ardhurave, ndërkohë shërbimi ‘Jouniversal’ gjatë viteve 2020 - 2023 luhet rreth 1-2%, ndërsa në vitin 2024 ky shërbim përbën rreth 7% të të ardhurave.

c. kostot përkatëse neto për ofrimin e shërbimit universal postar si dhe, për sa është e zbatueshme, vlerën korresponduese të kompensimit që mund të kërkohej nga operatori për ofrimin e shërbimit universal postar.

Bazuar në sa më lart, AKEP konstaton se, kostot përkatëse neto për ofrimin e shërbimit universal postar nuk janë llogaritur dhe paraqitur në AKEP nga Posta Shqiptare sh.a., sipas kërkesave të nenit 31, të ligjit nr. 46/2015 dhe rregullores nr. 41, datë 3.3.2016, “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”. Për pasojë, edhe nëse do të pretendohesh kompensimi nga Posta Shqiptare, nuk mund të kërkohej vlerë e barazvlefshme kompensimi në mungesë të kostove përkatëse neto të ofrimit të shërbimit universal.

Sipas nenit 9, pika 5 të VKM nr. 239, datë 02.05.2018, subjekti për ofrimin e shërbimit universal postar duhet të ketë jo më pak se 10% të të ardhurave të tregut postar.

Grafik 22. Pësja e pjesëve të tregut ndaj totalit të të ardhurave nga të gjithë ofruesit e shërbimeve postare



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare

Bazuar në të ardhurat e raportuara nga ofruesit e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë për vitin 2024, vërehet se pjesën e tregut më të madhe për këtë tregues vazhdon ta mbajë Posta Shqiptare (rreth 51%), e ndjekur nga DHL me rreth 16%, United Transport me rreth 8%, Albanian Delivery Express me rreth 7%, dhe ofruesit e tjerë postarë përbëjnë rreth 17% të totalit.

Siç vërehet nga grafiku, lidhur me treguesin e të dhënave financiare. Posta Shqiptare dhe DHL plotësojnë kriterin lidhur me të ardhurat e tregut postar ku ofruesi duhet të ketë mbi 10% të tregut, por subjekti DHL nuk plotëson kriterin e numrit të zyrave të disponueshme për publikun.

Përfundime

Këshillit Drejtues i AKEP me vendimin Nr. 2581, datë 22.06.2015 ka pajisur ofruesin “Posta Shqiptare sh.a”, me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjet nga hyrja në fuqi e vendimit. Sipas përcaktimeve të VKD 2581/2015 të AKEP, afati i përfundimit të autorizimit individual të Posta Shqiptare për shërbimin universal postar përfundon më 7 Korrik 2020.

Nga analiza rezulton se Posta Shqiptare Sh.a., është angazhuar në përmbushjen e detyrimeve për ofrimin e shërbimit universal, si edhe ka raportuar në mënyrë periodike realizimin e treguesve të cilësisë së ofrimit të shërbimit universal pranë AKEP. AKEP ka monitoruar çdo vit nëpërmjet raportimeve dhe inspektimeve realizimin e detyrimeve për ofruesin e shërbimit universal.

Në zbatim të pikës 7 të nenit 6 dhe pikës 3 të nenit 12 të Ligjit Nr. 46 datë 7.05.2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", si dhe, bazuar në analizën e situatës aktuale për prezencën e pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar, me urdhrin Nr. 469, datë 27.12.2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar”.

Sipas të dhënave statistikore për vitin 2024 mbi treguesit teknikë të rrjetit të Postës Shqiptare dhe

ofruesve të tjerë rezulton se ky kriter plotësohet vetëm nga ana e Postës Shqiptare e cila aktualisht ka në total 574 zyra të shpërndara në të gjithë territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë nga të cilat 535 të hapura për publikun dhe 38 zyra jo të hapura për publikun.

Si konkluzion nga analiza përfundimtare rezulton se në treg ka vetëm një operator, Posta Shqiptare Sh.a., që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin. Përcaktimi i ofruesit të shërbimit universal postar me procedurën e konkurrencës publikë do të bëhej vetëm nëse në përfundim të analizës së zhvillimit të tregut të kryer nga AKEP-i konstatohej që kishte, të paktën, dy ofrues të shërbimeve postare, të cilët mund të sigurojnë ofrimin e shërbimit universal postar, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Meqenëse Posta Shqiptare Sh.a., është operatori i vetëm që plotëson kushtet për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi, AKEP-i ka vendosur të miratojë përcaktimin e sipërmarrësit Posta Shqiptare si ofrues i shërbimit universal postar në Republikën e Shqipërisë, dhe si rezultat zgjatjen e afatit të autorizimit individual të ekzistues për sigurimin e shërbimit universal postar dhe do të lëshojë autorizimin e ri individual, sipas parashikimeve në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Aneks 1- Lista e sipërmarrësve të ofrimit të shërbimeve postare

Nga regjistri i ofruesve të shërbimeve postare i përditësuar deri më datë 19.05.2025, janë gjithsej 23 ofrues shërbimi postar aktiv që ofrojnë shërbime postare në Republikën e Shqipërisë, ku përfshihet edhe Posta Shqiptare, njëkohësisht është edhe Ofrues i Shërbimit Universal Postar.

Tabela 1. Ofruesit e shërbimeve postare

Nr.	Ofruesi i shërbimeve postare	Certifikata e Konfirmimit të Njoftimit	Shërbimet postare të regjistruara	Data e deklarimit të fillimit të shërbimeve postare
1	Posta Shqiptare SHA	Nr.2015-AISHP-0018 Dt. 05.01.2016	a. Shërbim jouniversal postar brenda vendit; b. Shërbim jouniversal postar me jashtë vendit; c. Shërbim postar ekspres brenda vendit; d. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; e. Postë direkte.	12.1.1999
2	DHL International (Albania) SHPK	Nr.2015-APSHP-0029 Dt. 08.01.2016	a. Shërbim postar ekspres brenda vendit; b. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; c. Shërbim postar me vlerë të shtuar.	29.12.2015

3	T.N.T Express Albania SHPK	Nr.2015-APSHP-0103 Dt. 08.01.2016	a. Shërbim jouniversal postar me jashtë vendit; b. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; c. Shërbim postar ekspres brenda vendit; d. Postë direkte.	07.01.2016
		Nr.2016-APSHP-00019 Dt. 30.05.2016 (Shtim shërbimi)	e. Shërbim jouniversal postar brenda vendit; f. Postë me shumicë; g. Postë hibride.	01.06.2016
4	Air Cargo Service SHPK (A.C.S.)	Nr.2023-APSHP- 3.1_162 Dt. 04.12.2023	a. Shërbim jouniversal postar brenda vendit; b. Shërbim jouniversal postar me jashtë vendit; c. Shërbim postar ekspres brenda vendit; d. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; e. Postë direkte; f. Postë hibride; g. Postë me shumicë.	05.1.2016
5	United Transport SHPK (Uni Trans)	Nr.2015-APSHP-0049 Dt. 07.01.2016	a. Shërbim jouniversal postar brenda vendit, b. Shërbim jouniversal postar me jashtë vendit, c. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit, d. Shërbim postar ekspres brenda vendit, e. Postë direkte (e paadresuar), f. Postë me shumicë brenda vendit, g. Postë hibride.	05.1.2016
6	Ulysses Enterprises SHPK (Fedex)	Nr.2015-APSHP-0121 Dt. 11.01.2016 Ndryshuar sipas kërkesës me nr. referencë: Nr. 2024-APP- 3.1_197 / datë 11.11.2024	a. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; b. Shërbim postar ekspres brenda vendit.	08.1.2016
7	Albanian Delivery Express SHPK	Nr.2015-APSHP-0016 Dt. 05.01.2016	a. Shërbim postar ekspres brenda vendit; b. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; c. Postë direkte.	22.7.2014

8	Youth Albania Professional Services (YAPS)	Nr.2015-APSHP-0017 Dt. 05.01.2016 Ndryshuar sipas kërkesës me nr. referencë: Nr. 2024-APP- 3.1_196 / datë 01.11.2024	a. Shërbim jouniversal postar brenda vendit; b. Shërbim postar ekspres brenda vendit; c. Postë direkte.	29.12.2015
---	---	---	---	------------

9	INTEX COURIER SHPK	Nr. 2019-APSHP-00049 datë 19.09.2019 Ndryshuar me kërkesë nr. 2023- APP-3.1_147 / date 30.05.2023	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit. d. Shërbim postar ekspres jashtë vendit e. Shërbim jouniversal postar jashtë vendit	01.10.2019
10	ALOPOST sh.p.k.	Nr. 2020-APSHP- 00066 / datë 23.06.2020	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit.	07.07.2020
11	Mr. COURIER sh.p.k.	Nr. 2020-APSHP- 00077 / datë 29.07.2020	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit	10.08.2020
12	Top Post sh.p.k	Nr. 2020-APSHP- 00084 / datë 14.10.2020	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit. d. Shërbim postar ekspres me jashtë vendi, e. Shërbim jouniversal postar me jashtë vendit	22.10.2020
13	Greenposta sh.p.k.	Nr. 2021-APSHP- 00088 / datë 29.01.2021	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit	01.02.2021
14	GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)	Nr. 2021-APSHP- 00121 / datë 15.06.2021 Ndryshuar sipas kërkesës me nr.reference: 2021- APSHP-00219 datë 14.04.2022	a. Shërbim postar ekspres brenda vendit, b. Shërbim jouniversal postar brenda vendit.	28.06.2021
15	BIPEX sh.p.k.	Nr. 2021-APSHP- 00143 / datë 27.09.2021 Ndryshuar sipas kërkesës me nr. 2022-APP-3.1_99 / datë 16.12.2022	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit. d. Shërbim jouniversal postar me jashtë vendit.	08.10.2021

16	IPOST sh.p.k	Nr. 2021-APSHP-00165 / datë 12.11.2021	a) Postë direkte (e paadresuar), b) Shërbim postar ekspres brenda vendit c) Shërbim jouniversal postar brenda vendit d) Postë me shumicë brenda vendit e) Postë hibride	01.12.2021
17	EXPRESS ALB 24 sh.p.k	Nr. 2021-APSHP-00174 / datë 16.12.2021 Ndryshuar sipas kërkesës me nr. . 2022-APSHP-00203 / 30.03.2022	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit. d. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; e. Shërbim jouniversal postar me jashtë vendit.	20.12.2021
18	POSTA JONE sh.p.k.	Nr. 2021-APSHP-00180 / datë 28.12.2021	a. Shërbim postar ekspres brenda vendit, b. Shërbim jouniversal postar brenda vendit	05.01.2022
19	POSTMAN sh.p.k	Nr. 2022-APSHP-00197 / datë 09.05.2022	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit	15.05.2022
20	Ultra C.E.P. sh.p.k.	Nr. 2022-APSHP-00228 / datë 08.08.2022 Ndryshuar sipas kërkesës me nr. 2024-APP-3.1_207 /18.02.2024	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit. d. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit	01.09.2022
21	Milsped Albania sh.p.k.	Nr. 2022-APP-3.1_84 / datë 21.12.2022 Ndryshuar sipas kërkesës me nr. reference 2023-APP-3.1_166 Ndryshuar sipas kërkesës me nr. reference 2024-APP-3.1_206 / datë 04.12.2024	a. Shërbim postar ekspres brenda vendit, b. Shërbim jouniversal postar brenda vendit. c. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; d. Shërbimjouniversal postar me jashtë vendit	01.02.2023
22	Elite Post sh.p.k.	Nr. 2023-APP-3.1_146 / datë 22.05.2023	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit	26.05.2023

23	ADEX sh.p.k.	Nr. 2024-APP-3.1_187 / datë 24.06.2024	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit. d. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit. e. Shërbim jouniversal postar me jashtë vendit	05.07.2024
----	---------------------	--	---	------------

Burimi: AKEP (Regjistri për Shërbimet Postare i cili përditësohet varësisht autorizimeve apo çregjistrimeve)